

## RRJEDHA E PUNËS 5 – Standartet minimale të operimit

### Veprimi 5: përcaktimi i procedurave të mbrojtjes lidhur me fotografimin, filmimin, sigurinë online, rrjetet sociale dhe bullizmin (online)

Përdorimi i telefonave inteligjentë dhe rrjeteve sociale paraqet sfida të reja për klubet sportive, si p.sh. prindërit që shpërndajnë foto ose video nga tribuna në rrjetet e tyre sociale pa pëlqim, bullizmi ndërmjet sportistëve të rinj përmes grupeve të komunikimit, apo marrja e fotove të papërshtatshme në dhomat e zhveshjes. Këto situata mund të çojnë në shkelje të kufijve personale dhe të privatësisë.

Klubet mund t'i reduktojnë këto rreziqe duke vendosur marrëveshje dhe rregulla të qarta. Këto rregulla duhet të përfshihen në rregulloret e brendshme të klubit dhe të sigurohet që ato t'u komunikohen rregullisht stafit, sportistëve dhe prindërve përmes disa kanaleve të komunikimit.

#### Udhëzime të rekomanduara

Rreziku	Udhëzime të rekomanduara	Këshilla
<b>Fotografi të fëmijëve shpërndahen në rrjetet sociale pa aprovim.</b>	Marrëveshje mbi pëlqimin me shkrim nga prindërit/kujdestarët për përdorimin e imazheve nga klubi, stafi i klubit dhe prindërit në llogaritë e tyre.	Gjithmonë siguroni pëlqimin me shkrim të prindërve/kujdestarëve përpara se të merren foto ose video gjatë aktiviteteve të klubit. Duhet të përcaktohet qartë qëllimi i përdorimit (p.sh. rrjete sociale, materiale promovuese, komunikim i brendshëm). Mendoni mënyra të qarta për të bërë të ditur se cilët fëmijë nuk duhet të fotografohen ose filmohen.  Punoni me fotografë të caktuar nga klubi, të cilët mund të ndajnë foto dhe video edhe me prindërit pas aktiviteteve..
<b>Fotografi të marra në dhomat e zhveshjes ose në hapësira të tjera private.</b>	Marrëveshje mbi përdorimin e kamerave dhe telefonave inteligjentë në hapësira sensitive për privatësinë	Rekomandohet ndalimi i plotë i fotografimit dhe filmimit në ambiente ku dikush është plotësisht ose pjesërisht i zhveshur.

	(p.sh. dhomat e zhveshjes, dushet, dhomat e ndihmës së parë/mjekësore, etj.).	
<b>Shpërndarja e imazheve të papërshtatshme ose poshtëruese.</b>	Marrëveshje në formën e një kodi sjelljeje mbi trajtimin me respekt të fotove dhe videove të njëri-tjetrit..	Klubet mund të vendosin që imazhet e shpërndara në kanalet zyrtare të miratohen paraprakisht nga një person i dytë.  Është e rëndësishme të ndërgjegjësohen prindërit, mbështetësit dhe sportistët mbi përmbajtjen vizuale që ata shpërndajnë.
<b>Përdorimi i imazheve (screenshot-eve, imazheve të manipuluar) për meme ose për bullizëm online.</b>	Marrëveshje në kodin e sjelljes mbi përdorimin me respekt të fotove dhe videove të njëri-tjetrit dhe mbi mënyrën e trajtimit të ndërsjellë..	Këto marrëveshje mund të hartohen së bashku me të rinjtë dhe të përfshihen në një kod sjelljeje, së bashku me marrëveshje të tjera..
<b>Trajnerët ose mbikëqyrësit ndjekin fëmijët në rrjetet sociale ose u dërgojnë mesazhe private.</b>	Marrëveshje mbi kontaktin online me të rinjtë.	Rekomandohet që trajnerët dhe mbikëqyrësit të kontaktojnë të rinjtë vetëm përmes kanaleve zyrtare të klubit (p.sh. grupe WhatsApp). Komunikimi individual digjital duhet të kufizohet vetëm në çështje sportive ose praktike dhe vetëm në rastet kur komunikimi në grup nuk është i mundur.  Sportistët e rinj duhet të kenë mundësi të shprehin se me cilat forma komunikimi ndihen rehat. Për shembull, ndjekja në Instagram mund të jetë e pranueshme, ndërsa marrja e mesazheve private shpesh jo. Snapchat zakonisht preferohet më pak. Klubet duhet t'i diskutojnë në mënyrë aktive këta kufij me të rinjtë dhe të vendosin marrëveshje të qarta ndërmjet sportistëve, trajnerëve dhe të rriturve përgjegjës.
<b>Fëmijët përballen me bullizmin online ose përjashtohen përmes grupeve të komunikimit.</b>	Mbikëqyrje nga një i rritur në të gjitha grupet e komunikimit që lidhen me klubin.	Bullizmi online shpesh është i vështirë për t'u monitoruar, por klubet mund të vendosin rregulla të qarta për kanalet digjitale të

		<p>komunikimit që përdorin me sportistët.</p> <p>Për më tepër, rritni ndërgjegjësimin e sportistëve mbi ndikimin e sjelljeve bullizuese, duke i diskutuar hapur dhe duke nxitur empatinë dhe respektin.</p>
<p><b>Shpërndarja e përmbajtjes së papërshtatshme përmes llogarive zyrtare të klubit.</b></p>		<p>Si klub, mund të përdorni një listë kontrolli (checklist) që duhet të plotësohet nga personi që publikon përmbajtjen, përpara se ajo të publikohet online.</p> <p>Shembull liste kontrolli:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Nuk lejohen foto ose video të sportistëve në pozicione poshtëruese ose ekspozuese</li> <li>- Nuk lejohen mesazhe politike</li> <li>- Nuk lejohet përmbajtje diskriminuese ose fyese</li> <li>- Nuk lejohen mesazhe ironike ose sarkastike që mund të keqinterpretohen</li> <li>- Komentet dhe vërejtjet duhet të jepen ballë për ballë, jo përmes rrjeteve sociale</li> <li>- Nuk lejohen pamje të ekranit (screenshots) nga biseda private</li> <li>- Etj</li> </ul>